

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo	 PRIŠTINA
	Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KOMUNA E PRISHTINËS, rruga UÇK-së nr.2 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; Dhe

Operatori Ekonomik: **RISAMONT SH.P.K., Kroj I Bardhe, 10 000, Prishtinë, Kosovë**, me numër unik të regjistrimit të biznesit **811273424** i përfshirë nga Riad Rexhepi – Drejtor, në tekstin e mëtejmë ("Ofruesi i shërbimeve"), janë pajtuar për kryerjen e shërbimeve në vijim:
Lënda e Kontratës: Mirëmbajtja e ndriçimit publik – LOT 4

Numri i Brendshëm i Prokurimit: 616 21 003 225

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: **Mirëmbajtja e ndriçimit publik – LOT 4**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit nga dy palët, efektive nga data e përcaktuar në planin e menaxhimit të kontratës dhe përfundon në periudhë prej 6 muajsh nga nënshkrimi i kontratës.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 6 muaj nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Prishtinë

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale e kontratës është **8.000,00 € (Tetëmijë euro)**. Çmimi njësi është: **954,75 (Nëntëqind e pesëdhjetë e katër euro dhe shtatëdhjetë e pesë cent)**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtronen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme në baza mujore.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet



5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit te Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenohen në përputhje me rr Ethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Zekë Bardhaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	08.08.2021
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	RIAD REXHEPI
Pozita:	DIREKTOR
Nënshkrimi:	
Data:	08.08.2021
Vula:	

1. PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkuar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “**Shërbimet**” do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “**Ofrues i shërbimeve**” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “**Personeli**” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nënkontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “**Çmimi i kontratës**” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “**Nënkontraktuesi**” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjese e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “**Palë**” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “**Palët**” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “**Autoriteti Kontraktues**” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “**KPK**” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “**KVK**” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i

Shërbimeve e transferon konratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë konratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas konratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e konratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të konratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e konratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të konratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e konratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmblushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të konratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas konratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përpunje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofroresi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofroresi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofroresi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimitari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofroresi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktivitetave.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofroresi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyë:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmبushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofroresi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofroresit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofroresit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofroresin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjeter e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tillë alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nationale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë konratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të janë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpert konratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë konratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet t'i paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimesht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofrueshin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofrueshit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofrueshit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrueshi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofrueshit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofrueshin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “*Menaxherin e Projektit*”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13

Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofroesë i sherbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha sherbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së sherbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zgresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofroesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofroesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit sherbime parandalon përdorimin e zakonshëm të sherbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofroesin e Sherbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofroesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënen e pjesës së mbetur të sherbimeve. Ofroesi i sherbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofroesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofroesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofroesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofroes i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroes i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësueset dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofroes i sherbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofroesit të Sherbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofroes i Shërbimit

15.1 Ofroes i Sherbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofroes i Sherbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofroesi i Sherbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofroes i Sherbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofroresi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jepin të drejtë Ofroresit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofroresi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 **Kualiteti i Kontrollit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofroresit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofroresit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofroresit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është sëç definuar në KVK.

Neni 18 **Përmirësimi i Defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofroresit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofroresi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoritati Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuenca e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofriuesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofriuesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofriuesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofriuesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te sigruar nga ofriuesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë

2. PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Data e fillimit të implementimit të kontratës	2.3	3 ditë pas nënshkrimit të planit të menaxhimit
Afat i liferimit pas porosisë përfurnizim apo ofrim të shërbimit	2.4	5 ditë
Rezervat	2.5	10 ditë pas nënshkrimit të kontratës OE duhet të ketë çdoherë rezerva të të gjitha produkteve të kontratës në stoqe.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim të ZKA-së
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është: 10% e shumës së përgjithshme të kontratës 800 € , e cila duhet të jetë valide 7 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	10% e vlerës së përgjithshme të kontratës
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <i>AK gëzon te drejtën qe ne baza ad-hoc te beje inspektimin ne pikë te caktuara per te siguarar se sherbiet janë duke u kryer ne përpjithje me kushtet e kontratës..</i> Periudha e përgjegjësise së Defekteve është 12 muaj
Pagesat		Pagesat realizohen në situacione
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Zyra për Ndërmjetësim – Ministria e Drejtësisë</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>në Gjykatën Themelore të Republikës së Kosovës</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.

MIRËMBAJTA E NDRIQIMIT PUBLIK -LLOTO 4 -KONTRATË KORNIZË

Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësie	Sasia	Çmimi me TVSH	Shuma me TVSH
A.				A. Totali (/ 70 % e pëllavë përi-vlerësim)	
1	Furnizimi, transporti dhe montimi i shyllës së hekurt ndriçuese-konike- H = 7.80 m.	copë	1	160.00 €	160.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave për trupat ndriques LED përi -30W.	copë	1	3.00 €	3.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave për trupat ndriques LED përi -42W.	copë	1	3.00 €	3.00 €
4	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave për trupat ndriques LED përi -50W.	copë	1	5.00 €	5.00 €
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i pllakave për trupat ndriques LED përi -100W.	copë	1	10.00 €	10.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafove për trupat ndriques LED përi -30W.	copë	1	8.00 €	8.00 €
7	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafove për trupat ndriques LED përi -42W.	copë	1	8.00 €	8.00 €
8	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafove për trupat ndriques LED përi -50W.	copë	1	8.00 €	8.00 €
9	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafove për trupat ndriques LED përi -100W.	copë	1	10.00 €	10.00 €
10	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit ndriçuese me poqë të CFL 60w, me lirë ,qelq dhe material tjetër i nevojshëm përforsim.Komplet	copë	1	40.00 €	40.00 €
11	Furnizimi, transporti dhe montimi i pocit ekonomik 60W .	copë	1	20.00 €	20.00 €
12	Furnizimi, transporti dhe montimi i kontaktonit TIP CN 160 A si 380 V i vendosur në orman të grusit matës.	copë	1	110.00 €	110.00 €
13	Furnizimi, transporti dhe shtirja e kabilos TIP PP OO 4x1.6 mm ² Al, prej shyllës në shyllë duke përfshirë gropimin si dhe materialet tjera të nevojshme gypa Ø63 shëriti vrojtues,gzl, rëra e imët 0.2x0.4, rëra e trashë zhavor 0.2x0.4 si dhe ngleshja e dhetut 0.4x0.4 (lligantja përm giatësi) -(kanali 0.8x0.4m)	m'	1	5.00 €	5.00 €
14	Furnizimi, transporti dhe montimi i bazamenteve për siguresa automatike 16A .	copë	1	3.00 €	3.00 €
15	Furnizimi, transporti dhe montimi i sigureave thikore 63A NH 00.	copë	1	5.00 €	5.00 €

16	Furnizimi, transporti dhe montimi i siguresave thikore 160A të vendosura në trafo për furnizim të ormanëve Indriçues	copë	1	5.00 €	5.00 €
17	Furnizimi, transporti dhe montimi i sugerave patron 63A R017 RT14 RT18 gg.	copë	1	8.00 €	8.00 €
18	Furnizimi, transporti dhe montimi i shyllës së betonit 9m.	copë	1	150.00 €	150.00 €
19	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit Led me këto karakteristika: Tensioni hyrës: 90-264 V AC,50-60 Hz, DC LED Q' ty& Fuqia:100W Frequency Range 50 – 60 HZ Eficiencia: min 120 lm/W Power LED Color Temperature: >4000K Material: Aluminium Qendrueshmëria min 50000 orë punë Garancioni 5 vite.	copë	1	70.00 €	70.00 €
20	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit Led me këto karakteristika: Tensioni hyrës: 90-264 V AC,50-60 Hz, DC LED Q' ty& Fuqia:30W Frequency Range 50 – 60 HZ Eficiencia: 120 lm/W Power LED Color Temperature: >4000K Material: Aluminium Qendrueshmëria min 50000 orë punë Garancioni 5 vite.	copë	1	40.00 €	40.00 €
21	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit led me këto karakteristika: Tensioni hyrës: 90-264 V AC,50-60 Hz, DC LED Q' ty& Fuqia:50W Frequency Range 50 – 60 HZ Eficiencia: min 120 lm/W Power LED Color Temperature:>4000K Material: Aluminium Qendrueshmëria min 50000 orë punë Garancioni 5 vite.	copë	1	50.00 €	50.00 €

22	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit led me këto karakteristika: Tensioni hyrës: 90-264 V AC,50-60 Hz, DC LED Q' ty & Fqiqat42W Frequency Range 50 – 60 Hz Efjencia: min 120 lm/W Power LED Color Temperature: >6000k Material: Aluminum Qandrueshmëria min 50000 orë pune Garancioni 5 vite.	copë	40.00 €	40.00 €
23	Furnizimi, transporti dhe instalimi i <u>kabilos</u> i TIP-it PP00 3x2.50mm ² Cu rë vendosura në shylla të qeliktë të drunjëta dhe rë betonit.	m'	1.00 €	1.00 €
24	Furnizimi, transporti dhe montimi e përcueseit i ndriç Publik 2 x16 mm ² . X00-A-Al, për i ndriçimi i është lagjeve	m'	1.00 €	1.00 €
25	Furnizimi, transporti dhe montimi i papueve, shticne, shtrëngues rëzhoiave për lidhjen e kabilove në orman për 4x50mm ² Al-Cu	copë	1.00 €	1.00 €
26	Furnizimi, transporti dhe montimi i papueve, shticne, shtrëngues rëzhoiave për lidhjen e kabilove në orman për 4x16mm ² Al-Cu	copë	1.00 €	1.00 €
27	Furnizimi, transporti dhe montimi i sigurave, automatike 16A.	copë	1	3.00 €
28	Furnizimi, transporti dhe vendosja e sigurësës automatike Schneider ose e ngashme 1–0–2–25A, e vendosur në ormanin e grupit matës.	copë	1	20.00 €
29	Furnizimi, transporti dhe montimi i kapakave të përforcuara me bulona përkatëse përmbytjen e sigurave të vendosura në shyllë të çelikët me lartësi të shyllave prej 5 deri 10 m të ndriçimit publikë.	copë	1	10.00 €
30	Furnizimi, transporti dhe montimi i kondenzatorve për pocia të Zhivës-125W	copë	1	10.00 €
31	Identifikimi i prishjes së kabilos me maknë speciale .	copë	1	50.00 €
32	Furnizimi, transporti dhe montimi i arallëtive për shylla të metalit me 4 pikë.	copë	1	30.00 €
33	Furnizimi, transporti dhe montimi i ftyave E-40 për vendosjen e poçave elektrike.	copë	1	0.50 €
34	Furnizimi, transporti dhe montimi i ftyave E-27për vendosjen e poçave elektrike.	copë	1	0.50 €
35	Furnizimi, transporti dhe montimi i redukuesve nga E-40 në E-27	copë	1	0.50 €
Total A:				889.50 €

B. Totali i (30 % e piltave për vlerësim)					
36	Demontimi i trupave ndriçues të dëmtuar dhe bartja deri në deponi te mbeturinave të licencuar.	copë	1	5.00 €	5.00 €
37	La gjini i shtyllës së dëmtuar dhe transporti në depo sipas urdhërit të policiës apo org. mbiqëqyrës gjatë 24 orëve (për t'jetë gjitha lojet e shtyllave).	copë	1	50.00 €	50.00 €
38	Drejtimi i shtyllës së lakuar të dërtuar dhe betonit.	copë	1	20.00 €	20.00 €
39	Furnizimi, transporti dhe montimi i shiritit të metalët me vrima për bulona M-6&M-8 për përfocim të trupave ndriçues në shtylla të dërtuar dhe betonit.	copë	1	1.00 €	1.00 €
40	Zhvendosja e shuerseve 125W. Bartja deri në deponi të mbeturinave.	copë	1	5.00 €	5.00 €
41	Furnizimi, transporti dhe montimi i bazës së siguresave ORS deri në 160A.	copë	1	30.00 €	30.00 €
42	Furnizimi, transporti dhe montimi i AS me shtjellim prej 43 Furnizimi, transporti dhe montimi i relese së fazave.	copë	1	120.00 €	120.00 €
43	Furnizimi, transporti dhe montimi i relese së fazave.	copë	1	1.00 €	1.00 €
44	Furnizimi, transporti dhe montimi i relese IC Astrologjike ,Siemes-Schneider,Abb ose të ngjashme.	copë	1	120.00 €	120.00 €
45	Programimi i relese IC Astro.	copë	1	10.00 €	10.00 €
46	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e kabilos nëntokësore PP OO 4x50 mm ² Al prej TS 20-10/0,4 KV gjel në ormanin e grupit matës duke përshtirë gropimin si dhe materialitet tiera të nevojshme gypa Ø63 shiriti vrojtues galvëra e imët 0.2x0.4,rëra e trashë zhavor 0.2x0.4 si dhe ngjeshta e dhet 0.4x0.4 (iloganita për 1m gjatësi) . (kanali 0.8x0.4m) .	m'	8.00 €	8.00 €	
47	Furnizimi, transporti dhe montimi i çeljët mbrojtës për trupa ndriçues sheshir 125 W.	copë	1	5.00 €	5.00 €
48	Furnizimi, transporti dhe montimi i vazhduesve kabilovik (mf) me dim. 50, 25, dhe 16mm ² (qmimi/Mesatarë)	copë	1	30.00 €	30.00 €
49	Furnizimi, transporti dhe montimi i tërheqëses së kabitit bisteck për seksion 2x16mm ²	copë	1	2.00 €	2.00 €
50	Furnizimi, transporti dhe montimi i unazave rrëth shtyllave për përfocimin e llauferit deri në 2x16mm.	copë	1	3.00 €	3.00 €
51	Furnizimi, transporti dhe montimi i Lidhëseve (klema) "Unimax", Al - Cu ose të tjera, për vazhdimin e përcuese në kabillo, shtylla të betonit dhe të drunjëta, me dimenz.. Të ndryshëm.	copë	1	1.00 €	1.00 €
52	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shiritit Fe/Zn 25 x 4mm. Lidhëseve katrore dhe materiali tjeteri i nevojshëm për tokëzimin e shtyllave të hekura dhe betonit. Komplet	m'	2.00 €	2.00 €	

53	Furnizimi, transporti dhe montimi i lirave një anësore (mbajtës të trupave ndriques 1.50m me hark)..	copë	1	25.00 €	25.00 €
54	Furnizimi, transporti dhe montimi i lirave dy anësore (mbajtës të trupave ndriques 1.50m me hark)..	copë	1	35.00 €	35.00 €
55	Drejtimi i lirave (një anësore) zbashku me trupat ndriquese.	copë	1	10.00 €	10.00 €
56	Furnizimi, transporti dhe montimi i njehsorit elektrikë trefazorë 3x230/400V direkt në tabelin-ormarin e grupit matus TIP "ISKRA" Digital ose e ngjashme.	copë	1	1.00 €	1.00 €
57	Punimi i bazamentit prej betonit MB 20 për vendosjen e ormanëve të grupit matës sipes skëvës dim 1.30x0.40x0.50m me bypa PVC Ø63mm. Komplet:	copë	1	60.00 €	60.00 €
58	Punimi i bazamentit betoni MB 30 për shyllja dhe materjal tjeter të nevojshëm. (0.80x0.80x0.80)m. komplet.	copë	1	40.00 €	40.00 €
59	Furnizimi, transporti dhe montimi i kuadrit qendror përfurnizimin e ndriqimit publik, me pjesën e gjamit shitetëngja jasht për leximin e njehsorit, pjesen e zbrazur rezervetë mbrojtur me dim (120.x90x30). -Nehësori elektrikë 3x230/400V 1 -Ndërpërresë A5-/A 1 -Transformatorë rrymotë /5 A 6 -Mikrondërpresë /A 1 -Portllampë E27 1 -Poç fluroshent 1x18w me baze 1 -Prizë OG 16 A 1 -Voltmetër Vm 0-500 V 1 -Ampermëtë Am 0-200A 1 -Ndërp. Zgjidhës për Am80-A-u-R10 1 -Ndërpërresë tipi GS-16-66 U 1 -Sig. Tripolare automatike /A te vendosura ne kuti per 3 siguresa komplete 3 ORS sigureza 9 patron /A -Siguresa njëpolare automatike 10-16A 6 copë schneider -Përgues 1x25 mm ² (m) 50 -Kontaktoë tip CS 160 ose 100A 3 -Ndërpërresë automatik/A 1 -Rele IC Astro 1	copë	1	400.00 €	400.00 €
60	Furnizimi, transporti dhe montimi i reduktoriëve të rrymës 200/5 A	copë	1	1.00 €	1.00 €
61	Furnizimi, transporti dhe montimi i reduktoriëve të rrymës 100/5 A	copë	1	1.00 €	1.00 €

62	Furnizimi, transporti dhe montimi i reduktoreve të rrymës 75/5 A	copë	1	1.00 €	1.00 €
63	Furnizimi, transporti dhe montimi i bazave të qelsave në dyer të ormanëve për qelsa 9 dhe 7 -trekëndësh .	copë	1	10.00 €	10.00 €
64	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave PVC Ø 100 – 160 mm gjatë kalimimeve osë de përtimit të rrugëve me makini speciale – asfaltit dhe kthimi në gjendjen e mëparshme.Crimimi për m' gjatësi.	m'	1	50.00 €	50.00 €
65	Furnizimi, transporti dhe montimi i dyerëve të ormanëve të ndriçimit publik.	copë	1	10.00 €	10.00 €
66	Furnizimi, transporti dhe montimi i halikave për flamuj për shyllat(druri betoni dhe metal) 6-10m. Vërejtje: Në çmim duhet të illogaritet që për çdo halkë të jenë nga tre gypa të shkurtër të metaltit të salduara dhe zingtuara ku vendosen flamujt.	copë	1	30.00 €	30.00 €
67	Largimi i banerave dhe reklamave nga shtyllat e ndriçimit publik vetëm me urdhëresë të org. Mbikëqyrës	copë	1	20.00 €	20.00 €
Totali B:					1,107.00 €